



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.38.dt.31.03.2000

**MBI**

**CELJEN E FONDIT TE PAGAVE DHE SIGURIMEVE SHOQERORE PER  
NDERMARRJEN ENERGJITIKE TE INDUSTRISE USHQIMORE TIRANE**

Këshilli Bashkiak Tiranë, i mbledhur më dt.31.03.2000 pasi shqyrtoi relacionin e Sektorit të Tregtisë në përbërje të Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik “Për çeljen e fondit të pagave dhe sigurimeve shoqërore” bazuar në V.K.M.- 673 dt.29.11.1995 pika 2, gërma a, “Për kriteret e përdorimit të të ardhurave të pushtetit loka” të ligjit 7776 dt.22.10.1993 “Për buxhetin loka”

**V E N D O S I**

1. Të miratohet çelja e fondit të pagave për tre roje me fond page mujore 37.2000 lekë. Fondi i pagave të çelet për periudhën 1 Janar deri më 31 Mars 2000. Fondi i pagave për këtë periudhë të çelet 111600 lekë gjithsej. Fondi i pagave për diverencat e periudhës 10.09.1999 deri më 31.12.1999 të çelet për 16.500 lekë. Në total çelet fondi i pagave 128110 lekë
2. Të miratohet çelja e fondit të sigurimeve shoqërore për tre roje me fond mujor 12.722 lekë. Fondi i sigurimeve shoqërore të çelet për periudhën 10.09.1999 deri 31.03.2000. Fondi i sigurimeve shoqërore gjithësej 84.813 lekë

3. Të miratohet çelja e fondit për komisionet bankare të pagave dhe sigurimeve shoqërore 450 lekë gjithesej
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoria e Financës
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas konfirmimit nga Prefektura Tiranë

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**



















